



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti
KUVENDI I KOMUNËS SË PRIZRENIT
Komiteti për Politikë dhe Financa
Më: 29 maj 2026

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, e mbajtur më 29 maj 2026 (e premte) në sallën e mbledhjeve të KPF-së, në “Shtëpinë e Bardhë”, me fillim në ora 10:00.

Pjesëmarrës nga KPF-ja, ishin: Simir Krasniqi, Kryesues i KPF-së, Arianit Berisha, Ymran Fusha, Trëndelina Kastrati, Dafina Alishani, Ilir Gashi, Haziz Hodaj, Agnesa Sinanaj Gavazaj dhe Shukri Quni, të gjithë anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Pjesëmarrës tjerë ishin: Nënkryetari i Komunës z. Kujtim Gashi, Përparim Shala dhe Muhamet Bajrami zyrtar nga drejtoria e Shërbimeve Publike, Islam Elshani – zyrtar nga Zyra komunale për Komunitete dhe Kthim, Emine Gashi – zyrtare ligjore nga drejtoria e Administratës, Arbër Krasniqi – zyrtar nga Sekori i Kuvendit, Dafina Krasniqi – Asistente e Kryesuesit të Kuvendit, dhe përfaqësues nga shoqëria civile dhe mediat lokale.

Simir Krasniqi (Kryesues): Atëherë fillojmë pra që jemi gati. Të nderuar anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa, të nderuar përfaqësues të mediave, i nderuar nënkryetar i Komunës zoti Kujtim Gashi, të nderuar përfaqësues nga drejtoritë komunale, zyrtarë komunal, përfaqësues nga OSBE-ja, të nderuar të pranishëm. Sot po e mbajmë mbledhjen e pestë për vitin 2026 të Komitetit për Politikë dhe Financa, të pranishëm jemi 8 anëtarë të KPF-së, meqënëse kemi kourum të mjaftueshëm, po e fillojmë me këtë mbledhje. Materialet dhe ftesat për mbledhje ju kemi shpërndarë me kohë sipas afateve ligjore, për punën e kësaj mbledhje të komitetit për politikë dhe financa, do të jetë ky rend dite:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së rregulltë të KPF-së, të datës 28 prill 2026;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Rendit të Ditës;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për subvencionimin e transportit urban;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i draft-rregullores për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Prizrenit;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i projekt-planit komunal për ri integrim të qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në Komunën e Prizrenit 2026-2028;

6. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për formimin e grupit punues për hartimin e Rregullores së Punës së Kuvendit të Komunës së Prizrenit;
7. Informatë mbi gjendjen e barazisë gjinore dhe realizimin e objektivave të strategjisë komunale për Barazi Gjinore 2024–2026 në Komunën e Prizrenit;

Pa humbur kohë, kalojmë te pika e parë:

Shqyrtimi dhe miratimi i i procesverbalit të mbledhjes së rregullt të KPF-së, të datës 28 prill 2026.

E hapim debatin rreth procesverbalit, a kemi me shtu diçka? Atëherë që nuk kemi me shtu e hedhim në votim. Sa jemi për? 8 jemi për. Unanimisht, pra votohet kjo pikë e rendit të ditës.

Kalojmë te pikat e radhës:

Shqyrtimi dhe miratimi i rendit të ditës.

A kemi me shtu rreth rendit të ditës? Atëherë që nuk kemi me shtu e hedhim në votim rendin e ditës. Sa jemi për? 8 për unanimisht pra rendi i ditës miratohet.

Kalojmë në pikën e tretë

Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për subvencionimin e transportit urban.

Këtu e kemi inicuesin e pikës pra, përfaqësuesin e shërbimeve publike, ju e dini që kjo pikë ka qenë edhe më herët edhe para kësaj seance në rend dite, po besoj që debati është shtjerr, po që doni konsultime, është përfaqësues i drejtorisë së shërbimeve publike. Po Dafina, fjala për ju.

Dafina Alishani (LVV): Edhe pse debati është shtjerr, ndoshta keni mund me reflektu pak a shumë prej diskutimeve dhe me sjellë një rekomandim duke i përfshi edhe fshatrat apo është prapë avazi i vjetër, prapë po doni me bë këtë ndasi siq e keni tentuar me e bë në seancën e kaluar unë prapë po i bëj thirrje edhe juve edhe kësaj qeverisje, që këtë ndasi mes fshatit dhe qytetit mos me bë në këtë vendim. Nëse mundeni me i bërë për të gjithë qytetarët e Prizrenit, gjithë linjat atëherë edhe Lëvizja Vetëvendosje do ta votonte. Po me këtë ndaësi, duke i prioritizuar operatorët ekonomikë e assesi qytetarët, mendoj që jeni duke i bë dëm edhe jeni duke e shty në ndarje për të cilën Prizreni shumë edhe ka vuajt edhe ka pas domethënë pengesa të tilla, kështu që ju kisha lutur me reflektu këtë thirrjen e shumë kuvendarëve që ishin atë ditë në diskutim. Edhe me gjet një modalitet ku nuk diskriminohen fshatrat përmes këtij vendimi, faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit Dafina, dikush tjetër, po Shukri Quni.

Shukri Quni (BDP): Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë. Ne atë ditë, në fakt mua më ra që propozova me e shtu këtu në këtë dokument, pra për propozim vendim për subvencionimin e transportit urban, ne kërkuam që të shtohet, domethënë edhe një pikë kështu ta

quaj, që përfshihen edhe viset rurale. Edhe kjo do të thotë nuk ka pësuar kurrë ndryshimi, ajo hyri në votim, u votua dhe nga anëtarë të tjerë të kuvendit, pasi ndërhyt, atëherë prapë hyri në votim edhe ata të cilët e votuan me zemër i detyruan që mos ta votojnë edhe kjo pikë u largu nga rendi i ditës. Kështu që, unë po e shoh që kjo pikë nuk ka kush e dinë sa peshë edhe mu heq krejt so problem. Se kërkund në botë nuk ju paguhet krejt njerëzve, nëse doni me na çu krejtve në raste sociale me na bart edhe me autobus edhe na që shtëpia na s'punojmë më hiç, ne duhet me punu me na siguruar rrogën e mirë, unë e paguaj rrugën, udhëtimet ngado që shkoj, kisha thënë me heq krejt këto edhe mos me u marrë na fare me këto. Janë rregullat, janë ligjet të cilat edhe në Evropë, por duhet me nxjerrë shumë dokumenta se ne të gjithë kemi anëtarë të familjes në përfundim. Atyre ju sigurohet udhëtimi, invalidëve, pensionerëve, edhe njerëz që janë domethënë me dokumente të cilat ja jep socialit e paguan shteti. Nuk kam pa ende që me ju pagu udhëtimi arsimtarëve, megjithëse ne e bëjmë atë që shkon prej Prizrenit në Nashec vjen i paguhet rruga, mua s'më u ka paguar asnjëherë që 37 vjet punoj, pastaj polici, mjek, punëtorë. Përkundrazi nuk i kemi shti këtu punëtorët e ekoregjionit, nëse meritojnë për mos me pagu rrugën janë ata, për mua ata janë heroj, se ata po na heqin bërlllogun, ne çka bëjmë ata i heqin dhe ka një rrogë më të ligën, s'ka ku shkon më poshtë. Nëse dojmë kolegë kuvendar me bë një punë të mirë, këtë e kishim heq krejt, arsyet janë, s'ka nevojë me ju pagu njerëzve të shëndoshë që ja ka dhënë zoti tona të mirat në trup e me ja pagu rrugën, po le të punojnë njerëz e ta paguajnë rrugën, ta paguajnë udhëtimin vet. Ne ata të cilët i ceka, mos t'i them edhe njëherë, kudo në botë ju paguhet. Kështu që mos shkojmë se nganjëherë që po e përdorim një fjalë popullore për një grusht vota, duhet me i ra pishman edhe atë që e kemi votu, mos pendoheni pastaj për ato që po i votojmë. Nëse të kujtohet nënkryetar kur u rrok njëherë PDK-ja për këto autobusa e tu përçan e tu bënë llom, jo ky po e merr jo ai jo ky po e merr e jo ai, tu bë pike e pesë. Kjo ka me ju bë juve, ka me ju kushtu që keni me u habit. Prandaj mos merrni lloj-lloj propozime që edhe unë kur të jap njëherë ndoshta ndonjë propozim më duket i mir por jo të gjithëve. Ky propozim nuk është ka më duket i mirë, nëse ju e shihni të udhës se e di që i keni votat, se tash s'di kush ka mbet, më duket unë edhe Dafina kemi mbetë opozitë. Keni me kalu, ky s'ka me ju dalë i mirë, qysh ju ka dal i mirë ai përpara, ata autobuset e siniket, të kujtohet më herët. Largojeni këtë pikë prej rendit të ditës edhe hiqni krejt, se ne jemi ka shkojmë veç të poshtë, s'ka nevojë me jetu na me vitra, me lëmoshë, me raste sociale. A pranoni ju dikush me ju pagu juve udhëtimin? Unë për vete s'pranoj, se hala s'kam ra, kur e di që dal në pension edhe si kam kushtët po, mirë është me ma siguru, a sa kam rrogë me ma pagu dikush mua udhëtimin, e vij unë sikur zotëni këtu me mercedes apo tjetri me X5 me Q7 me 10 me i pagu udhëtimi me dalë me hyp në autobus pa pagesë nuk është në rregull. Mos të bëjmë politikë që nuk ja vlen, hiç lirisht unë jam kundër asaj që kjo edhe atë ditë kish me u heq krejt ose përfshini të gjitha, për çka po i ndani ata të gjitha fshatrat përfshini. Prandaj hiqeni krejt prej rendit të ditës se kurgjo s'fitoni hiç as ka me ti livdu kush për këtë. Unë nuk e votoj, nuk e votoj se edhe subvencione s'po di ku po merrni paret tash ju, po thonë që po ja u merr përmbaruesi s'po ja len asnjë cent, e këtë tash po gjojmë pare ne për me ja dhënë dikujt tenderet për autobus dhe me fitu dikush në interes personal vazhdo.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit, fjalë për ju Haziz Hodaj.

Haziz Hodaj (LDK): Faleminderit, përshëndetje për të gjithë, që është e vërteta, kjo pikë u konsumu e u harxhua definitivisht edhe në mbledhjet e kaluara, qoftë komitetit për politik dhe financa, qoftë në seancë dhe prej komitetit për politikë e financa ndryshoi me kërkesën tonë, është paraparë që në faza pastaj të hyjnë edhe kategori të tjera të rajonit në subvencionim. Mirëpo, si duket qysh është gjendja financiare e Komunës së Prizrenit s'do të ndodhë asnjëra as tjetra përfundimisht definitivisht. Edhe shpejt jo qytetarët, qysh po i shoh sendet shpejt do t'ju shohim edhe juve zyrtarëve që keni kerre zyrtare tu ecë në këmbë, se nuk di a do të ju jetë para me pagu naftën, kështu që ne morëm e s'morëm vendim, dyshoj që ka me ndodhur, derisa përmbaruesi ju rri në hazër në çdo alokim të mjeteve dhe i fut duart në xhepa të Komunës deri në brryla, është problem mandej me realizu çdo projekt, përndryshe si e votove si se votove, po ma merr mendja që nuk ka me ndodhur asnjëra as tjetra. Sido që të jetë, parashikimi, domethënë planifikimi për me pagu për me i fut në faza edhe kategori të tjera, ne e kemi pranuar, do ta pranojmë prapë, po skepticizmin e kemi këtu, në tavolinë, faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit.

Dafina Alishani (LVV): A bën edhe një pyetje?

Simir Krasniqi (Kryesues): Po, Dafina.

Dafina Alishani (LVV): Kjo u votu në kuvend, unë s'po kuptoj pse tash prapë edhe njëherë me e sjellë.

Simir Krasniqi (Kryesues): Nuk kaloj pra me propozimin e Shukri Qunit që ish dhe u largua si pikë, është sjellë tash këtu.

Dafina Alishani (LVV): Organi më i lartë e vendosi ashtu.

Simir Krasniqi (Kryesues): Po e vendosi tash e sjellim në kuvend dhe si është kështu. A kemi diskutime të tjera?

Dafina Alishani (LVV): Qysh a ka ndryshuar këtë herë?

Simir Krasniqi (Kryesues): Jo, nuk ka ndryshuar e njëjta është. A kemi diskutime të tjera? Atëherë që nuk kemi e hedhim në votim. Sa jemi për? 6 për. Kundër? 2. Abstenim? 0. Atëherë miratohet pika që t'i rekomandohet kuvendit në mbledhjen e radhës.

Kalojmë në pikën e katërt të rendit të ditës.

Shqyrtimi dhe miratimi i draft rregullores për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Prizrenit.

Këtu e kemi inicuesin e pikës, fjala për ju.

Muhamet Bajrami (Zyrtar DSHP): Faleminderit Kryesues, përshëndetje të gjithë, jam këtu për me u'a prezantuar draftrregulloren për menaxhimin e ndërtimoreve, kemi përgatitur një raport i cili është përgatitur i përputhur me kornizën ligjore duke u bazuar në të gjitha ligjet e Republikës së Kosovës të tanishëm. Domethënë kjo draft rregullore ka filluar me inicimin e formimit të komisioni i cili me vendim të kryetarit të datës 30.01.2026 është formuar grupi punues prej shtatë anëtarëve i cili ka pas për detyrë kthimin e draft-rregullores për menagjimin e mbeturinave. Ky grup punues ka mbajtur tetë takime ku ka diskutuar për të gjitha çështjet dhe ka bërë takimin e kësaj rregullore, rregullora është publikuar në web faqe, domethënë me 27.04, edhe në disa platforma të tjera në Facebook, edhe përmes mediave është lajmëruar përmes reçejeve dhe është konsultimi publik me datën 05.05.2026 ku kanë marrë pjesë 37 prej këtyre 28 meshkuj 9 femra ka pas komente, kërkesa, domethënë kjo është në përgjithësi, tema kryesore e kësaj rregullore ka qenë menaxhimi i mbeturinave. Deri tash menaxhimi i mbeturinave është bërë përmes komunës, inkasimin e ka bërë komuna, ndërsa me këtë rregullore kompetencat i kalohen kompanisë shërbyese domethënë ekoregjionit do të bëjnë inkasimin e mjeteve, edhe kemi bërë një ndryshim të tarifave, domethënë në përgjegjësi, duke pas parasysh trajtimet edhe të cilin jetojmë, shtrajtimet private, shërbime. Kjo është në pika të shkurta.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit për informatë, e hapim debatin. Po, fjala për ju Arianit Berisha,

Arianit Berisha (PDK): Përshëndetje për të gjithë, përveç atyre që u thanë, e kuptojmë nevojën për ndryshimin e tarifave, por pyetja ime ka të bëjë zyrtarët e Ekoregjionit a kanë paraparë një rritje të rrogave për punëtorët e kësaj kompanie, nëse po qysh e kanë bërë përllogaritjen, pak më shumë rreth kësaj pjese, nëse mundesh.

Muhamet Bajrami (Zyrtar DSHP): Për Ekoregjion s'munë të flas, nuk e di, se i kanë politikat e veta, ma merr mendja ky shkaktim do të ndikoj edhe në rritjen e parë, sigurisht që po.

Arianit Berisha (PDK): Domethënë gjatë diskutimeve në ndryshimin e rregullores nuk ka qenë, nuk është diskutuar kjo pjesë.

Muhamet Bajrami (Zyrtar DSHP): Jo, kjo është pjesa e Ekoregjionit.

Arianit Berisha (PDK): A do ta kemi nesër dikë të Ekoregjionit?

Simir Krasniqi (Kryesues): Të martën, që është e nevojshme.

Haziz Hodaj (LDK): Jo, duhet patjetër me qenë.

Arianit Berisha (PDK): Mendoj që duhet me qenë dikush prej Ekoregjionit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Mund të jenë dikush, po fjala për ju Haziz Hodaj. Faleminderit Arianit.

Haziz Hodaj (LDK): Faleminderit, unë pajtohem me fjalën e zotit Berisha dhe kërkesën dhe singlerisht desha me pyet me ju drejtu bashkë menaxhmentit të Ekoregjionit, a ju vjen keq që herën e kaluar në kuvend bët një kërkesë sot e përmendi edhe zotri Quni që me i trajtu si kategori sociale, realisht me i shti në kategorinë e tyre që duhet me pas pagesa për transport urban, kur unë po besoj që është një ndërmarrje shërbimeve publike stabile që ka të hyra mjaft edhe tash me kërku që punëtorët e tyre me qenë në kategori sociale, personalisht më kisha ardhur keq më pas qenë në udhëheqje të kësaj kësaj kompanie, këtij shërbimi. Kështu që do duhej patjetër me qenë këtu dhe do duhej nëse ju bëni kërkesë me i rrit tarifat, sigurisht që duhet me kanë edhe mbështetje të atyre punëtorëve që realisht janë heroj të punës. Personalisht po edhe po besoj që janë të kënaqur edhe qytetarët me shërbimet e tyre, janë çdo gjë në nivel dhe andaj kur janë çdo gjë në nivel rreth shërbimeve duhet me u shpërbly ata punëtorë edhe me paga ty i krahasu këto shpenzimet që thatë nafta, se për të gjithë nëse rriten çmimet e naftës e çmime të tjera të jetësore rriten edhe për punëtorët e ekoregjionit. Kështu që do duhej me marrë përsipër nëse e menagjoni ju ekoregjionin atëhere duhet me marrë përsipër edhe me i mbrojt të drejtat e punëtorëve. Kështu që unë po kërkoj që në mbledhje me qenë patjetër një përfaqësues i ekoregjionit edhe me marrë aj faktikisht një zotim se nëse e marrim një vendim me i rritë tarifat aj do të duhej me u zotu para neve që ka me i rritë edhe pagat e punëtorëve. Faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit baca Haziz, fjala për ju Shukri Quni.

Shukri Quni (BDP): Faleminderi kryesues. Këtu kemi kolegë që janë me dekada në këtë kuvend, edhe Kujtimi nuk është bash i vjetër, ju kujtohet mirë edhe ju kryesues, po flas për më herët që sun e kemi bërë grumbullimin e mjeteve edhe për tatimet në komunë po edhe për ekoregjionin. Ka qenë një kusht që është bërë për me regjistruar kerrin duhet me pas pagesën, e ne kemi votuar në asamble, edhe ajo u konsideruar si shkelje të drejtat e qytetarëve, nuk bën me kushtëzu edhe këtu farë gjërash edhe u heq domethënë e regjistrin kerin pa këto. A keni me qenë të sigurtë që keni me i grumbullu mjetet, në fakt tash ti nuk je i ekoregjionit po sa kam me pas sukses në grumbullimin e mjeteve nëse e merr ekoregjioni mu largu prej komunës, me marrë si kompani në vete. A kam me pas sukses apo për vaki ja lënë punën krejt se nuk e thashë për politikë, se unë kur kemi bërë ne fshatrat kërkesë për me u përfshir edhe fshatrat me i grumbullu mbeturinat, për mua ka qenë festa më e madhe. Se ne i kemi derdh bërllugun ne i thojmë në breg, e sot kur vjen ai unë po të them në fshat nuk le kush pa ju qitë nga një kafe atyre punëtorëve se len. Se po shkon te dera po ja u merr bërllugun. Kishte bërë një kërkesë një kuvendar turk me e lënë një kontejner aty atyre qytetarëve të juaj të Prizrenit, që mos me i derdhë bërllugun nëpër katund, e ne qohemi të shkretët i mbledhim. Kjo është një punë e shenjtë mos harroni, po unë jam tu e frigu që a po ka sukses me i grumbullue ekoregjioni këto mjete vetëm këtu kam frikë se edhe me shtrejt pak hiq se kam dert, se puna më e mirë është për mua ajo. Në përfundim po flas, se s'kam jetuar në përfundim po më kallëzojnë, më shtrenjt paguhen qeta që i mbledhin, bile sa di shteti nuk janë kompani private sa jam i informuar nëse ka shteti në duar kompani për grumbullimin e mbeturinave. Unë çdo përkrahje i jap kësaj por po frigona që mos po dështoni me grumbullimin e mjeteve. Se ne shqiptarët po flas për kombin tem për shqiptarët e mi s'po flas për të tjerë, na harrojmë shpejt dhe

s'vjen me hek berllogun thojmë hajt se ti jap. A di sa ka pasë borgje ky ekoregjioni që sun i ka mbledhë, sja jepshin...

Muhamet Bajrami (Zyrtar DSHP): Menagjimi i mbeturinave komuna e ka marrë nga viti 2015, sivjet është viti i 12-të, domethënë prej vitit 2015 nuk ka lokalitet që nuk bëhet shërbim, domethënë prej 2015-s. Kam qenë pjesë e këtij menaxhmenti prej fillimit edhe deri në fillim kena pasur shumë vështirësi, se kur është shtri, domethënë në vendet ku s'është bërë kurrë shërbimi kan pas telashe për pagesa, nuk paguishin, pagushin evidente, kushtëzimi që ka ekzistuar përmes rregullores, domethënë regjistrim i kerrit ka qenë një arsye më e fortë që i ka detyruar njerëzit me paguar, po edhe tatimin në pronë, edhe për urbanizëm, të gjitha ato. Për regjistrim të kerrit u dha mundësia përmes internetit me u pajis me fima edhe duli prej ideas kjo punë, po tatimi në pronë dhe ata e ndalën me një arsyetim pse jo shkelje ligjore nuk e di, edhe pak u ndal inkasimi, edhe pse prej vitit 2015 komuna mungesë stafi aq sa ka mujt me bë, kurrë s'kena mund me mbulu shërbimin që e ka bë kompania. Prej se janë heq këto kushtëzime, borxhi është rritur, jo tash pas parasysh që jam marrë me këtë punë, nuk është puna që nuk dojnë me pagu njerëzit, një pjesë e madhe e tyne e paguajnë, ndoshta për arsye neglizhence, atëherë kur ka qenë kushtëzimi i detyronte, tash dikush i ka 50, dikush 100, edhe për këtë arsye ne e kemi kaluar te ekoregjioni që derë në derë për dikën kish me qenë më lehtë me pagu çdo muaj dhe ne besojmë që ata kanë me grumbulluar mjete më shumë sesa ne domethënë kjo është një arsye që ka kalu te ata. Tash i sigurt s'mund me thënë a mund me e grumbullu ajo po e besom që kam me e bë

Kujtim Gashi (Nënkryetar): Nëse ka mundësi pak. Me plotësu diqka.

Simir Krasniqi (Kryesues): Po nënkryetari e ka fjalën.

Kujtim Gashi (Nënkryetar): Faleminderit, e para sa i përket mbledhjes të mbeturinave ne kemi qenë komuna e vetme që i kemi mbledhë mbeturinat në regjon. Tash janë disa vite secila komunë e ka kaluar në kompani dhe në basë të një analize që e kemi bërë në këto komuna të tjera kompania ka arritur me mbledh të hyrat në përqindje shumë të lartë, ndërkaq në komunën tonë përqindja ka qenë e ulët, komuna pra nuk ka treguar efikasitet në mbledhjen e mjeteve përse i përket mbeturinave dhe kjo ka qenë arsyeja kryesore pse kemi menduar që duhet me kaluar në inkasim nga ana e vetë kompanisë, me i mbledhë në fund të fundit të hyrat që i takojnë kësaj kompanie, edhe e ka një mundësi shtesë, të cilën ne nuk e kemi praktikuar po asnjë komunë në republikë të Kosovës ata e kanë edhe sistemin e përmbarimit, nëse qytetarët nuk i paguajnë për një periudhë të caktuar, tre, gjashtë, nëntë, 12 muaj, ata e kanë lehtësisht mundësinë me i çu në përmbarim. Na ka mësuar qeveria, se kjo përmbarimi tash u ka bë modë në republikën e Kosovës, po mirë që po funksionon edhe e kanë mundësinë me i mbledhë të hyrat tash sa i përket me thirrë kompaninë në seancë, okej, është kjo e drejtë, por na mos harrojmë se i kemi tre përfaqësues aty, dy i ka kuvendi, një kryetar i komunës. Para së gjithash ndoshta është mirë me diskutuar kuvendi me aksionerët që janë pjesë e kompanisë, aty është prej asamblesë, Endriti, edhe ky Temaj, Astriti, edhe Bexhati është prej ekzekutivit si përfaqësues, edhe këta kanë përgjegjësi për shkak se janë pjesë e menaxhimit të lartë të ndërmarrjes, por natyrisht edhe kryeshefi si menaxher i drejtpërdrejtë i

kompanisë është mirë me ardhur këtu, përndryshe sa i përket tarifave me aq sa kam hulumtuar, përkundër që rritet pak, prapë tarifat në Prizren janë më të ulëta në raport me qytetet e mëdhaja të republikës së Kosovës. Po kjo normal vjen si pasojë në ndryshimeve të çmimeve, te naftat, te pagat, të gjithë kategoritë që janë rritur, përndryshe unë mendoj që ka me qenë veprim i suksesshëm, kalimi i mbledhjes së mbeturinave nga komuna në kompani sepse duhet me u pajtuar që nuk kemi kapacitete për me i mbledhur mbeturinat. Ne nëse mund me mbledhë tatimin në pronë i kemi punë të mirë, aty megjithëse janë disa ndëshkime dhe kjo është arsyeja pse po paguhet më shumë, kurse te mbledhja e mbeturinave nuk kemi pse ne me kryer punë për kompaninë, kompania i kryen punët e veta dhe i mbledh mjetet e veta sepse ata në fund të fundit këto mjete të cilat ne i kemi mbledhë deri tash prej mbeturinave na dash veç me bë një shërbim edhe me ja kaluar prapë kompanisë. Domethënë ato mjete i kemi pagu prapë kompaninë për shërbime, kështu që le të kalojnë në kompani, edhe komunat për rreth e kanë bë të njëjtin veprim edhe kanë pas rezultate më të mira se ne, unë s'po flas që ne s'kemi pas rezultate në mirëmbajtjen e qytetit, po ne inkasim s'kemi pas, mirëmbajtja është bë për shkak se ne kemi paguar mjete dhe kur ata edhe kur s'i kemi mbledhur, ne kompanisë ja kemi paguar pa i mbledhur. Domethënë mjetet e kategorive të tjera i kemi bartur te kompania me qëllim që me u kryer shërbimet edhe me u mbledhë mbeturinat në gjithë territorin e komunës së Prizrenit, po besoj që është veprim i drejtë edhe ka me pas rezultate.

Haziz Hodaj (LDK): Sigurisht që ka me pas rezultate se ata, ata i përdorin masat mandej vetë edhe dalja në secilën derë për derë me i mbledh parët është shumë më e efektshme se personalisht vetë harroj shpesh harroj me shku me i pagu, po kur të vjen mënyrë është tjetër. Edhe diçka kam kam një pyetje, te tabela e kategorizimit dhe tarifat e shërbimeve thotë tarifat sipas kategorive, kategoria e parë, tani zona rurale 7.5 deri në 10.5, cila është rritja këtu? Kategoritë po i lexoj, kategoria e parë po thotë zona rurale. 7.5 deri në 10.5, ndërsa zona urbane 8.5 deri në 11.5.

Muhamet Bajrami (Zyrtar DSHP): Sa më shumë e kemi lënë kompanisë duke i pas parasysh në terren që ata janë vetë, shembull marrim në qoftë se kategoria është një market, ndryshe është një market 20 m2, ndryshe është 50m2.

Haziz Hodaj (LDK): Unë jam duke fol tash për një kategori, për kategorinë e parë, se kategorinë po i shoh të tjera që janë kanë tarifa të tjera dhe arritje të tjera, mirëpo hapësira prej 7.5 deri në 10.5, cila është? Se këtu ka hapësirë mandej ai me bë këtë çmim prej 7.5 deri në 10.5 qysh don ai. Se ne po e votojmë duhet me pas një çmim.

Kujtim Gashi (Nënkryetar): Po i ke të ndame te tabela e dytë kategoria e parë, e ke tabelën tjetër. Po për ty amvisëria është me rëndësi janë 7.5 të tjerat janë kategori të tjera biznese...

Haziz Hodaj (LDK): Këtu u pa që është na fund 7.5 kështu definitive cila është ajo?

Kujtim Gashi (Nënkryetar): Amvisëri rezidenciale e ke 7 euro në muaj është në tabelën e fundit për biznes, amvisëri jo rezidenciale ke 3 euro në muaj. Tash e ke për kontejner secilën veç e veç po këto janë pak më shumë punë të kompanisë.

Muhamet Bajrami (Zyrtar DSHP): Bizneset që s'paskan kontejner edhe s'janë amvisëri janë të ndarë në kategoria e parë dytë tretë katërt edhe në bazë të aktiviteteve që kanë edhe është përcaktuar tarifa prej që kaq deri në që kaq, e përmenda marketin, mund me kanë 20 m2, mund me kanë 50 m2, marketi bjen me një kategori të veçantë, për shembull në dysh ose në njësh edhe mbas asaj ata caktohet tarifa mbas gjenerimit të mbeturinave, s'kan mund me e lënë një për shembull për një për market 10 euro kur një market është shumë i vogël s'ka punë.

Kujtim Gashi (Nënkryetar): Abi i ka pesë kontejnera, marketi këtu në bazhdarhane e ka një.

Haziz Hodaj (LDK): Rritja për amvisërit rezidente është 7€ prej sa sa ka qenë 5.50.

Simir Krasniqi (Kryesues): Po Dafina e ka fjalën.

Dafina Alishani (LVV): Po më intereson kjo mungesa e inkasimit a ka qenë se është se ka pak staf edhe se më herët domethënë nëse s'gaboj Xhajka i ka pas një projekt të cilin edhe i ka asistuar komunën edhe s'po di a ka qenë më e suksesshme atë periudhë kur kanë pas projekt apo jo. Domethënë a është mungesa e stafit pyetja ime e parë, e dyta puna e kontejnerëve kush i bën investimet në kontejner, se unë po e shoh nëpër qytet që ka shumë kontejner të cilët janë ose të dëmtuar, ose të djegur, të thyer, a i ndërron ekoregjioni apo komuna. Edhe pyetja ime e fundit ju bën disa kontejnerë që u futen nën tokë, ato a nuk po shfrytëzohen, a nuk janë tu funksionu apo çka është puna e qatyre kontenjerëve?

Muhamet Bajrami (Zyrtar DSHP): Xhajka e ka pas projektin e vetë, e ka kryer edhe ka shkuar, na ka përgatitur neve, kur kemi filluar në 2015 tha po s'kanë pas të bëj më hiç me këtë projekt, domethënë ata na kanë përgatitur edhe kanë shkuar kanë përgatitur sistemin i përket inkosimit, kjo është direkt mungesa e stafit prej fillimi, domethënë s'kam pas, s'kem mund me dal në terren me i verifiku amvisëritë, u përmend këtu inkasimi, kemi një numër të madh që hala nuk e dinë që 12 vjet qysh është puna e tyre, domethënë që 12 vjet ka shumë amvisëri që s'kanë paguar, me pas pasur staf me siguri na e kishim zgjidh atë problem dhe kjo automatikisht na ka ulur përqindjen e inkasimit. Se me pas pas një databazë të saktë, shkon e njëjta sikur për komuna të tjera, përqindja ishte qenë shumë më e madhe. Kontejnerat po bën furnizim komuna, e kompania i shpërndan dhe kujdeset për ta, po për momentin me të vërtetë është në gjendje shumë e keqe kontejnerave, domethënë janë të dëmtuar, problem edhe për punëtorët që punojnë me ta, është problem i madhë, ndërsa sa i përket kontenjerave tokësor janë vendos diku një 20-ën, nuk e di a kam funksion njëherë apo jo, nuk e di sakt vitin, po këto me funksionu s'kanë funksionu asnjëherë, kam vrejtje sektorit, praktikat e qyteteve të tjera që kam dështuar me ken rekomanduar që mos me po janë bë më shumë janë bë si pika të zeza se që janë funksionale.

Shukri Quni (BDP): A ban edhe një pyetje?

Simir Krasniqi (Kryesues): Po, Shukri Quni e ka fjalën.

Shukri Quni (BDP): Këtu ne po shkojmë me e mbrojtë qytetarin, po kqyrim me ja pagu rrugën me i'a pagu shpenzimet, a mos po e ngarkojmë ne qytetarin tash me këtë grumbullim të mjeteve? Se deri tani unë i kam paguar në komunë, kam paguar pesë herë në vit, për tërë vitin e paguajsha thash edhe një euro ja hepsa atij aty. Tani ky ka me nxjerrë atë faturë, ka me hy tvsh-ja në faturë ka me hy edhe diçka tjetër sikur te hidroregjoni, se na i japim pare hidroregjionit, e ka 0.55 cent e ka kubin e metrit, i harxhon 20 m³ ke me shku herë 0.55 cent 19 cent e ka për kanalizim, qajo shtohet e cila ngarkon edhe më tepër, plus shkon tvsh-ja domethënë qytetarit këtu na s'jemi duke i ndihmu por jemi tu ja ngarku qytetarit mir në një barrë. Plus ka me hy edhe aty ndonjë tjetër send aty se s'ka qare pa hy aty, po pse na me ja pague hidroregjionit kanalizimit për çka, çka bën ai mua në kanalizim?

Simir Krasniqi (Kryesues): Ujërat që po derdhën po shkojnë aty.

Shukri Quni (BDP): Kush, ai nuk e ka ndërtuar le të shkon me mirëmbajt atje rrugën e Nashecit që po i qet ai kanalizimet prej asaj gropës aty ku e ka aty Wc, e qet në asfalt edhe kam lajmëruar në inspektoriat edhe s'marin kurrëfarë mase. Ky ka të drejtë me shku me shpëraz ato gropat edhe me i çu në vendin e jo me i qit në rrugë. Unë me këto ndoshta këta e kanë paraparë më mirë, veç këto qytetarët ju nuk keni i ndihmue se këto na shtohen kam pagu 5.50, pse qysh jo?

Kujtim Gashi (Nënkryetar): Këto janë tarifa fikse domethënë ai e ka brenda këtij.

Muhamet Bajrami (Zyrtar DSHP): Grupi punues i kemi llogaritur të gjitha gjërat për me ardhë deri te kjo shumë që është caktuar. Unë si pjesë e këtij sektori deri tash kemi pas ankesa që s'kanë dashur me pagu, veç asnjëherë se kam pas një ankesë që është shtrenjtë prej ndonjë qytetari. Mu kjo më ka ardhë mirë a di se njerëzit janë të kënaqur me shërbimin edhe për këtë edhe prej 7 ndoshta prej 5.50 ndoshta për momentin është pak shumë për qytetarin po edhe deponia që e bën deponimin e këtyre mbeturinave dhe ajo i ka ngritur tarifat për kompaninë edhe ajo ka pak.

Kujtim Gashi (Nënkryetar): Me këtë trend të çmimeve kemi pas rrijte vitin e ardhshëm prapë se prap ne e kemi lirë 7.50 e ka propozuar Suhreka edhe është nja tre herë më e vogël dy herë se na po ta bëjmë njëherë kështu tani kqyrim. A përndryshe la Shukë 7 është fiksi, tarifa tvsh-ja brenda 7, po të flas për ekoregjonin për hidroregjonin nuk e di ajo është kompani e qeverisë.

Dafina Alishani (LVV): Ato paret që po i kursejn në transport publik qytetari ka me i pagu në mbeturinë.

Shukri Quni (BDP): Po si kryeministri qato që po ja jep ka 100, po ti merr në rrymë.

Kujtim Gashi (Nënkryetar): Na ka msu tash aj na po e grehim teposhtë.

Simir Krasniqi (Kryesues): Atëherë a kemi diskutime? Që skemi diskutime e hedhim në votim që këtë pikë të i'a rekomandojmë kuvendit në mbledhjen e ditës së martë që do të mbahet në 2 qershor. Sa jemi për? Unanimisht pra kjo pikë i rekomandohet kuvendit pra shqyrtimi dhe miratimi të rregullores për menaxhimin e mbeturinave në komunën e Prizrenit.

Kalojmë te pika e pestë:

Shqyrtimi dhe miratimi i projekt-planit komunal për riintegrim të qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në komunën e Prizrenit 2026-2028.

E kemi inicuesin e pikës këtu, fjala për ju Islam.

Islam Elshani (Zyrtar për Komunitete dhe Kthim): Përshëndetje të gjithëve, zyra komunalet edhe kthim që nga viti 2012 nga qeveria e Republikës së Kosovës është angazhuar, domethënë me persona të riatdhesuar respektivisht me integrimin, me riintegrimin e personave të riatdhesuar, kështu që zyra komunale për komunitetet dhe kthimë këtë punë e punojmë që nga viti 2012 deri në ditën e sotme, edhe pse gjatë, gjatë këtyre viteve kemi, domethënë edhe ngritje, kemi edhe edhe zbritje të fluksit të personave të riatdhesuar nga Europa përëmdimorë. Ne si zyre komunale për komunitete dhe kthim do të thotë jemi angazhu nga qeveria e Republikës së Kosovës dhe këtë punë kryesore që e punon domethënë që punohet për personat e riatdhesuar merret ministria e punëve të brendshme respektivisht departamenti për riintegrimin e personave të riatdhesuar, ka qenë më herët, kurse tash dy vite, rreth dy vite është shtuar edhe riintegrimi i të huajve. Por sa i përket rintegrimit të huajve, niveli lokal nuk merret me ta, vetëm njoftohen, domethënë zyrë komunale për komunitete dhe kthim, kurse përgjegjësinë kryesore për integrimin e të huajve e ka ministria e që përmenda më herët. Plani nacional, për integrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar vitin e kaluar ka qenë domethënë në periudhën 2023-2025, ka skaduar vitin e kaluar, kështu që këtë vit është punuar në hartimin e planit nacional për integrimin e personave të riatdhesuar për periudhën 2026-2028. Kështu që në këtë drejtim ne si zyrë komunale për komunitet dhe kthim kemi parashtruar kryetarit të komunës kërkesën për formimin e komisionit në hartimin e këtij plani nacional veprimit për riintegrim mandej ku në mesin e mesin e anëtarëve të komisionit kemi pas edhe nga shoqëria civile këtu ceket mandej kemi pasur edhe debatin publik ku ka pas persona të riatdhesuar, por sa jam i njoftuar unë domethënë me debatin publik nuk kemi pasur ndonjë koment ose ndonjë propozim ose ndonjë shesë. Sa i përket riintegrimit dhe riatdhesimit që nga viti 2014-2016 kur ka qenë fluksi më i madh tani fatmirësisht nuk e kemi atë fluks të personave të riatdhesuar që nga 1 janari domethënë i vitit 2024, kur është bërë liberalizimi i vizave, domethënë kur Kosova si shtet ka hyrë në Shengen, e kemi të dukshëm e kemi zbritjen e numrit të personave të riatdhesuar. Tani për momentin kemi diku rreth shtatë apo tetë familje që janë të akomoduar nga ana e ministrisë në punëve të brendshme edhe kryesisht tani që kthehen janë persona me të kaluar kriminale, persona të cilët kanë probleme të rënda shëndetësore edhe shtetet e perëndimit, tani ne merremi me ta. Duhet të ceket që ky plan aksional i veprimit nuk ka kosto, domethënë komuna e Prizrenit jo vetëm komuna e Prizrenit por asnjë komunë në Republikën e Kosovës nuk ka ndonjë kosto sa i përket mbulimit të këtyre aktiviteteve apo më mirë themi, ndihmave që ju afrohen këtyre personave të riatdhesuar, kjo kishte me qenë e tëra, nëse ka eventalisht dikush ndonjë pyetje, faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit për sqarim, e hapim debatin. A don me marrë fjalën dikush?

Shukri Quni (BDP): Vetëm pak se tash këtu megjithse e kam kqyr unë po këë s' di. Persona me të kaluar kriminale domethënë që kërkojnë riatdhesim e thamë, cilit komunitet i takojnë?

Islam Elshani (Zyrtar për Komunitete dhe Kthim): Kërkoj falje që harrova me e cekë, zyra për komunitete dhe kthim ajo kryesisht mirrët me personat apo mirret me komunitetet minoritar në krejt rast kemi të bëjmë me riatdhesim atje përfshirjen të gjitha komunitetet pak. Nuk e di sa jam i qartë edhe personat e riatdhesuar janë të gjitha ato persona të cilët nuk e kanë zgjedhur problemin e qëndrimit nëpër vendet e ndryshme të Europës edhe me vetë faktin që ata nuk e kanë zgjedhur çështjen e qëndrimit për ato vende në marrëveshjen me qeverinë e Republikës së Kosovës e që kjo ka qenë një prej standarteve për liberalizimin e vizave për shtetin e Kosovës, por kjo është marrje.

Shukri Quni (BDP): A janë që janë popullatë e jona e Kosovës?

Islam Elshani (Zyrtar për Komunitete dhe Kthim): Këta janë shtetas të Republikës së Kosovës. Sa i përket këtyre të huajve, tashi në Luksinburg, sa i përket këtyre të huajve, këta që kthehen, persona të huaj, janë kryesisht nga vendet e konfliktit dhe ata janë nën mbrojtjen ndërkombëtare edhe i kemi në Prizren ne si zyre e komuniteteve domethënë jemi të njohur që i kemi vetëm nja dy apo tre familje, kemi një familje të nga Palestina, një nga Jordani, duket edhe ne vetëm i dimë ato familje, por ministria e punëve të brendshme është kompetente me u marrë me ta, jo ne, ne vetëm e përcjellim situatën.

Shukri Quni (BDP): E keni një punë goxha të rëndë se çka s'është duke hy te na.

Islam Elshani (Zyrtar për Komunitete dhe Kthim): Atë ditë kur është mbajtur ndëgjimi publik, aty e kemi pas prezent edhe Berat Gashin që është zyrtari i lartë regional nga ministria e punëve të brendshme dhe ju përgjigjë atyre se ne jemi dëshmitar, qytetarët e komunës së Prizrenit jemi dëshmitarë që kemi shumë nga Palestina, kemi shumë që rrijnë që kërkojnë lëmoshë e tjerë e tjerë po ata nuk janë persona të riatdhesuar, nuk janë nën mbrojtje ndërkombëtare, ata vijnë thjeshtë si turistë.

Haziz Hodaj (LDK): Jo, ata nëse marrin viza kalojnë nëpër këto filtra kur ipen vizat, nëse s'marrin viza ata kanë hy të zezë, duhet duhet me i trajtu edhe edhe ata që hynë të zezë normal me i trajtu me i çu në shtëpi të vet.

Simir Krasniqi (Kryesues): A ka diskutues tjerë, atëherë që nuk ka e hedhim në votim pikën e rendit të ditës që t'i rekomandohet kuvendit. Unanimisht pra pika e pestë miratohet dhe i rekomandohet kuvendit për mbledhjen që do të mbahet ditën e martë.

Kalojmë në pikën e gjashtë:

Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për formimin e grupit punues për hartimin e rregullores së punës së kuvendit të komunës së Prizrenit.

Këtu pra është pikë e kuvendit që do të caktohet një grup punues prej asamblesë, e keni edhe përbërja se si do të bëhet nga një përfaqësues nga grupet parlamentare dhe një përfaqësues nga komuniteti turk dhe një nga komuniteti boshnjak. Arsyeja pse kemi kërku pra gjatë diskutimeve me zyrtarët ligjorë të kuvendit, ka disa udhëzime të reja që janë dalë mbas rregullores dhe duhet të bëhen ato përmirësime, pra është e nevojshme shumë që gjatë punës ky grup punues do ta sheh që është e nevojshme që të ndërhyhet në këtë rregullore të punës së Kuvendit. Hapim diskutimin që keni diçka me pyet, mirë që nuk kemi, atëherë e hedhi në votim.

Haziz Hodaj (LDK): Një kërkesë, po sigurisht që do të del edhe në kuvend, është mirë në grupin punues me u përfshi të gjithë përfaqësuesit e partive politike që janë në kuvend, bëhet fjalë për një rregullore që i prek të gjithë, kështu që ndoshta do të ishte mirë, nëse nuk ka nonjë ndonjë kosto, nuk ka ndonjë ndonjë pengesë ligjore, pse me mos me u përfshi të gjitha gjithë përfaqësues të partive politike që janë në kuvend.

Simir Krasniqi (Kryesues): Mirë aty që e shihni të arsyeshme janë edhe tre subjekte politike që nuk përfaqësohen, pra është AAK-ja, NISMA dhe kjo lista GUXO. Jo, atëherë na shtohet se janë edhe këto partitë e komunitetit edhe gjashtë shtesë ndoshta mos po bëhet grupi i madh.

Haziz Hodaj (LDK): . Sa më i madh që bëhet problemet më të mëdhaja, mandej komplikohet situata më shumë.

Shukri Quni (BDP): A jemi duke fol për rregulloren e kuvendit ne me caktu. Në rregullore shkruan “fjalën e merr shefi i grupit më të madh PDK-së pastaj vjen lëvizja Vetvendosje, LDK, Bashkimi Demokratitë, ja ka dhënë fjalën, shefave të grupeve, prej 5 deri në 10 minuta nvalet qysh e cakton” më kujt i teket s'ka pas aty, ti e ke marrë atëherë fjalën kur a ka tash dikush me shtu ose me heq, qekjo është në rregullore, plus ka qenë grupi ai ka qenë Naser Bresa e ka formu grupin 4+ u thirrke. Sun delshe ti aty kujt i teket me dalë me marrë fjalën. Në rregullore shkruan flet Dafina Alishani për grupin e lëvizjeve vetëvendosje, 5 minuta apo 10 sa caktohet ajo, u kry muhabeti. Ose tash te minoritetet po flas, minoritetet e formojnë një grup të vetin, një flet në emër të tyre, këto grupe të tjera që janë le ta bëjnë edhe këta një, njëri le të flet në emër të tyre, jo aty tash na tash sa partia është aty po mendoj sa individë në emër të një partie janë. Janë disa rregulla.

Simir Krasniqi (Kryesues): Na si Kuvend ndarjen e kemi përcjellë me grupe parlamentare dhe nga një kemi shkuar prej komunitetit turk, një komunitetit boshnjak.

Haziz Hodaj (LDK): Te shefat e grupeve, ata që kanë grupe të kuvendarëve të anëtarëve të kuvendit, ata janë shefa dhe kanë të drejtën e shfrytëzimit të minutazhes nëse është më e gjatë, anëtarët e kuvendit që nuk përfshijnë grupe parlamentare, ata janë si anëtarë thjeshtë të kuvendit.

Shukri Quni (BDP): Po ai po del sikur shef i grupit. Minutazhen e merr sikur unë.

Haziz Hodaj (LDK): Minutazhin e rregullt që e ka secili anëtar tjetër i kuvendit, qashtu do duhet me qenë në rregullore ashtu, se s'unë ja u merr të drejtën atyre me diskutu. Mirëpo ata kanë të

drejtën sa një anëtar i kuvendit tjetër, po e zëm ti e je shef sa është e drejta e një anëtari tjetër. Në rregullore qashtu është.

Shukri Quni (BDP): Në rregullore është por s'është tu zbatuar.

Simir Krasniqi (Kryesues): Me e pasë si në parlament të Kosovës që në mënyrë automatike me ju ndalë mikrofoni kur të kalon minutazhi edhe është shumë mirë edhe kryesuesi do të jetë jetë më mirë. Atëherë kjo është përbërja, shkon në kuvend, e diskutojmë edhe në kuvend, e ke përbërjen tre janë zyrtarë të kuvendit, janë partitë politike nga grupet parlamentare, nga një përfaqësues, është nga një prej komunitetit boshnjak, një prej komunitetit turk, domethënë kjo është përbërja ne që e kemi përcjellë materialin e ke tash ky është materiali që e kemi përcjellë.

Shukri Quni (BDP): Po ti e përmende me hy.

Simir Krasniqi (Kryesues): Jo nuk e përmenda.

Haziz Hodaj (LDK): Jo unë e kërkoja.

Shukri Quni (BDP): Po ai ta miratoj.

Haziz Hodaj (LDK): Jo nuk e miratoj, tha e dërgojmë në kuvend.

Shukri Quni (BDP): Aty duhet komplet minoritetet me pas një, le ta zgjidhin ata ku dojnë ata.

Kujtim Gashi (Nënkryetar): Unë ja u jap një propozim në emër të komunitetit, e thirrni nënkryetarin për komunitet dhe është përfaqësuesi i krejtve e ka zgjedhur kuvendi.

Simir Krasniqi (Kryesues): Mirë atëherë e hedhim votim që t'i rekomandohet kuvendit kjo pikë e rendit të ditës, sa jeni për? Unanimisht pra rekomandohet kuvendit pika gjashtë e rendit të ditës, shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për formimin e grupit punues për hartimin e rregullores së punës së Kuvendit të komunës së Prizren.

Kalojmë në pikën e shtatë:

Informatë mbi gjendjen e barazisë gjinore dhe realizimin e objektivave të strategjisë komunale për barazi gjinore 2024-2026 në komunën e Prizrenit.

E kemi përfaqësuesin pra këtu që na jep informata, fjala për ju, prezantohu njëherë.

Emine Gashi: Përshëndetje të gjithëve, jam Emine Gashi zyrtare ligjore, njëkohësisht jam duke e zëvendësu kolegën që është pushim edhe është në prag të pensionit. Kështu që po vazhdoj. Informatë mbi gjendjen e barazisë gjinore dhe realizimin e objektivave të strategjisë komunale për barazinë 2024-2026 në komunën e Prizrenit. Kështu materialin e keni, në pika të shkurtra e kam përgatitur në një raport. Ky raport paraqet një përmbledhje të zbatimit të strategjisë komunale për barazi gjinore në komunën e Prizrenit, duke u bazuar në monitorimin e realizuar dhe gjetjeve relevante institucionale dhe të shoqërisë civile. Monitorimi është bërë mbi zbatimin e strategjisë

dhe planit të veprimit përparazi gjinore 2024-2026 për punës së Prizrenit. Strategjia synon avancimin e pozitës së grave dhe vajzave në jetën publike, ekonomike dhe sociale. Komuna ka bërë progres në krijimin e mekanizmave institucional dhe përfshirjen e perspektivave gjinore në dokumentet strategjike, ende ka sfida në zbatimin praktik të objektivave, sidomos në buxhetimin gjinor, është rritur përfaqësimi i grave në kuvendin komunal, por jo mjaftueshëm në pozita udhëheqëse dhe ekzekutive, gratë vazhdojnë të kenë pjesëmarrje të ulët në tregun e punës dhe në mundësitë ekonomike, janë realizuar iniciativa pozitive për fuqizimin ekonomik të grave përmes trajnimeve, subvencioneve dhe vetëpunësimit, në arsim janë organizuar aktivitete sensibilizuese përparazi gjinore dhe në kuadër të dhunës. Ky është një raport i shkurtër.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit, e hapim debatin që keni me pyet po fjala për ju, Shukri Quni.

Shukri Quni (BDP): Emine, nuk bëne mirë që e kritikove pushtetin, se nuk është në ekzekutiv barazia gjinore, mungon barazia gjinore. E ky ekzekutivi im ky s'bën me kritiku hiç, këtyre veç duhet me iu thënë ju e keni mirë, me ju s'ka.

Haziz Hodaj (LDK): Këtë raport ajo e ka, kjo veç e lexoj.

Shukri Quni (BDP): Gjithmon thuaj në emer të Mybegjeles, sa femra janë tash drejtoresha?

Kujtim Gashi (Nenkryetar): Katër. Inspektoriatit, kulturës, tatimit në pronë, arsimit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Edhe zëvendes kryesuesja pesë. A e hedhim në votim pikën e rendit të ditës që të i'a rekomandojmë kuvendit? Sa jemi për që kjo pikë t'i rekomandohet kuvendit? Unanimisht votohet kjo pikë dhe i rekomandohet kuvendit pra për mbledhjen e radhës në ditën e martë më 2 qershor. Ju faleminderit për pjesëmarrjen.

Mbledhja e KPF-së, përfundoi në ora 11:30

